

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË
KUFIZUAR
ELITE GROUP AUSTRIA SHPK**

INDEKSI

INDEKSI	2
KREU I	3
EMRI I SHOQERISE, SELIA, KOHEZGJATJA, OBJEKTI	3
NENI 1	
EMRI I SHOQËRISË	
NENI 2	
SELIA	
NENI 3	
KOHËZGJATJA	
NENI 4	
OBJEKTI I SHOQËRISË	
KREU II.....	5
KAPITALI I SHOQËRISË TRANSFERIMI I KUOTAVE.....	5
NENI 5	
KAPITALI I SHOQËRISË	
NENI 6	
TRANSFERIMI I KUOTAVE TË KAPITALIT TEK TË TRETËT	
NENI 7	
BARRA MBI KUOTAT E KAPITALIT	
KREU III.....	6
ORTAKET E SHOQERISE, FINANCIMET	6
NENI 8	
ORTAKET	
NENI 9	
VENDIMET E ORTAKEVE	
NENI 10	
FINANCIMI I SHOQËRISË	
KREU IV	6
ADMINISTRIMI I SHOQËRISË	6
NENI 11	

ADMINISTRIMI I SHOQËRISË	
NENI 12	
SHPËRBLIMI I ADMINISTRATORIT	
KREU V	8
KONTROLI KONTABËL I SHOQËRISË	8
VITI FINANCIAR DHE BILANCI	8
NENI 13.	
KONTROLI KONTABËL	
NENI 14	
VITI FINANCIAR.....	
NENI 15	
BILANCI DHE REZERVAT	
KREU VI	9
PRISHJA DHE NJOFTIMET	9
NENI 16	
PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE	
NENI 17	
NJOFTIMET	
KREU VII	9
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE.....	9
NENI 18	
LIGJI I ZBATUESHËM.....	

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I SHOQËRISË ME
PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ELITE GROUP AUSTRIA” SHPK**

**KREU I
EMRI I SHOQERISE, SELIA, KOHEZGJATJA, OBJEKTI**

NENI 1 EMRI I SHOQËRISË

1.1 Sot, ne Tiranë më me date 01.11.2021,:

Arlind Kote i biri i Ilirit dhe Artes i datelindjes 05/03/1989 lindur dhe banues ne Tirane me numer personal I90305044T

themelon këtë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin :

“ ELITE GROUP AUSTRIA ” Shpk (Me poshte e quajtur “Shoqeria”)

NENI 2 SELIA

2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet ne adresen: Rr.Murat Toptani, Kalaja e Tiranës kati 2, njesia bashkiake nr 2.

2.2 Ortaket mund të vendosin mbi transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjetër. Personat përgjegjes për administrimin e Shoqërisë mund të çelin ose mbyllin degë dhe/ose zyra përfaqësimi si brenda ashtu edhe jashte Republikës së Shqipërisë.

NENI 3 KOHËZGJATJA

3.1 Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj për një periudhe kohore me afat të pacaktuar duke filluar nga data e regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

NENI 4 OBJEKTI I SHOQËRISË

4.1 Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen dhe marrjen pjesë në të gjitha aktivitetet që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtroje në bazë të legjislacionit shqiptar, dhe në veçanti:

Import Eksport tregtimin e te gjithë mallrave te ndryshem me shumice dhe pakice ne te gjithë boten. Tregtimin e te gjithë llojeve te produkteve , te sherbimeve ,te pronave te luajtshme dhe te paluajtshme, te cilet jane te kompanise ose te paleve te treta. Ofrimin e pagesave te menjehershme ose me keste per keto produkte dhe sherbime sipas politikave te ndryshueshme.

Tregtimin e makinave, pjeseve te makinave, aksesoreve te makinave , lubrifikanteve, produkteve dhe nen produkteve per makina, dhe cdo sherbimi apo produkti qe ka lidhje direkte ose indirekte me makinat tregtimin por edhe prodhimin e tyre.

Dhenie me qera te makinave por dhe mjeteve te tjera te luajtshme dhe te paluajtshme.

Tregtimin e rrobave, vesh mbathjeve, ushqimeve, kepuceve, shapkave, cizmeve, paisjeve elektronikeve te te gjitha llojeve, pijeve, cigareve, pijeve energjitike por dhe te te gjithë llojeve te

produkteve te ndryshme.

Marketing

Karburante, qendra gazi por dhe te elektricitetit,

Programe kompjuterike por edhe telefonike

Markete, supermakrete etj

Autoshkolla

Prodhimin por edhe tregtimin e mjeteve elektronike , kabujve te ndryshem, etj

Ofrimin e Kurseve,degeve profesionale, arsimit 9 vjecar te mesem edhe te larte nga kapacitetet e veta ose dhe si ndermjetes.

Realizimin e ndermjetesit tregetar por dhe te gjithë llojeve te tregetive

Realizimin e platformave online per ofrimin e sherbimeve dhe produkteve nga shteti ne shtet ose brenda shteteve ne baze te synimeve dhe objektivave te caktuara kohe mbas kohe.

4.2 Për më tepër shoqëria mund të vepronte si agjent/ndermjetes për kryerjen e aktiviteteve të mësipërme dhe bazuar në diskrecionin e saj të vetëm mund të kontraktonte palë të treta për kryerjen e një pjese apo të të gjitha sherbimeve te mesiperme.

4.3 Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të saj përfshirë edhe aktivitetin e ofrimit të sherbimeve, tregtimin, importimin dhe eksportimin e mallrave.

4.4 Për të arritur objektin e saj, Shoqëria mund të realizojë drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë çdo lloj pjesëmarrje në shoqëri të tjera shiptare apo të huaja, si edhe të hyje në marrëdhënie kontraktore, bashkëpunimi ose ortakërie me persona të tretë, privatë ose publike, vendas ose të huaj.

KREU II KAPITALI I SHOQËRISË TRANSFERIMI I KUOTAVE

NENI 5 KAPITALI I SHOQËRISË

5.1 Kapitali i Shoqërisë është 100,000 Lek, i përbërë nga 1 (nje) kuote, me vlerë 100.000 Lek secila, i ndare si me poshte:

Arlind Kote , zoterues i 1 (nje) kuota, qe perfaqeson 100% (njqindperqind) te kapitalit te shoqerise, me vlere totale prej 100,000 Lek.

Derdhja e kapitalit do te kryhet pas regjistrimit te Shoqerise ne regjistrin tregtar, gjate fazes se zhvillimit te aktivitetit te Shoqerise.

NENI 6 TRANSFERIMI I KUOTAVE TË KAPITALIT TEK TË TRETËT

6.1 Transferimi i kuotave të kapitalit të Shoqërisë mund të bëhet me shitje, falje, trashëgimi, ose me çdo mënyrë tjetër të parashikuar nga ligji.

6.2 Në rast transferimi të kuotave tek persona të tretë jashtë Shoqërisë, qoftë me shitje qoftë me dhurim, ortakët që synojnë të transferojnë kuotat duhet t'i komunikojnë ortakëve të tjerë vullnetin e tij me shkrim. Ortakët e tjerë kanë të drejtën e parablerjes të kuotave të ortakëve, me kushte të barabarta, dhe duhet ta ushtrojnë këtë të drejtë brenda 30 ditëve nga marrja e komunikimit të vullnetit të ortakut për të transferuar kuotat.

6.3 Vlera e kuotës që transferohet do të përcaktohet me marrëveshje ose nga një ekspert i emëruar nga ortakët me marrëveshje ose nga gjykata në rast se ortakët nuk bien dakort.

NENI 7 BARRA MBI KUOTAT E KAPITALIT

7.1 Kuotat e kapitalit të Shoqërisë mund të rëndohen lirisht me barrë siguruese apo të drejta të tjera reale

KREU III ORTAKËT E SHOQËRISË, FINANCIMET

NENI 8 ORTAKËT

8.1 Ortaku i vetëm i shoqërisë është:

Arlind Kote i biri i Ilirit dhe Artes i datelindjes 05/03/1989 lindur dhe banues në Tiranë me numër personal I90305044T

NENI 9 VENDIMET E ORTAKËVE

- 9.1 Ortakët, në përputhje me legjislacionin shqiptarë marr vendime në lidhje me :
- a) Ndryshimin e këtij Statuti

- b) Zmadhimin e zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë
- c) Kalimin e kuotave të Shoqërisë
- d) Emërimin dhe shkarkimin e administratoreve si dhe emërimin e shkarkimin e ekspertit(eve) kontabël të autorizuar
- e) Miratimin e bilancit vjetor të Shoqërisë si edhe të cdo raporti tjetër financiar
- f) Shndërrimin, shpërndarjen dhe likuidimin e Shoqërisë
- g) Emerimin e likuidatorit(eve) dhe cdo vendim tjetër që sipas ligjit i takon ortakut të vetëm

9.2 Vendimet e Ortakeve duhet të merren me shkrim dhe të regjistrohen në regjistrin e mbajtur pranë selisë së Shoqërisë.

NENI 10 FINANCIMI I SHOQËRISË

10.1 Organi i Administrimit të Shoqërisë në përputhje me dispozitat në fuqi përveç rasteve të zmadhimit të kapitalit ka të drejtë të kërkojë nga ortakët e Shoqërisë fondet e nevojshme për arritjen e objektivave të shoqërisë

10.2 Financimet e mëtejshme të ortakeve në shoqëri do të jenë me shpërblim (interesa) apo pa shpërblim, në varësi të titullit nëpërmjet të cilit do të levrohen këto fonde.

KREU IV ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

NENI 11 ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

11.1 Shoqëria administrohet nga një Administrator ;

Arlind Kote i biri i Ilirit dhe Artes i datelindjes 05/03/1989 lindur dhe banues në Tiranë me numer personal I90305044T , për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë riemërimi

Administratori shkarkohet nga detyra, në çdo kohë, me vendim të zakonshëm të Asamblesë së Përgjithshme sipas Statutit të Shoqërisë.

Veprimet e administrimit të Shoqërisë do të konsiderohen të vlefshme nëse janë ndermarre dhe nënshkruar nga administratori.

Administratori është përgjegjës për çështjet e përditshme të Shoqërisë dhe përfaqëson Shoqërinë në marrëdhënie me të tretet në përputhje me dispozitat e Statutit ose ligjit të zbatueshëm.

11.2 Administratori ka të gjitha kompetencat e zakonshme dhe të jashtëzakonshme për administrimin e Shoqërisë, përveç atyre që sipas Statutit ose ligjit të zbatueshëm i takojnë

Asamblese se Pergjithshme. Ne rast te me shume se nje administratori, Asambleja e Pergjithshme mund te vendose qe administratoret mund te veprojne bashkarisht ose veç e veç.

11.3 Administratori ka kompetencat dhe detyrat e meposhtme:

- a) mbikeqyr dhe zbaton politiken e biznesit te Shoqerise;
- b) perfaqeson Shoqerine;
- c) kujdeset qe Shoqeria te zbatoje ligjet dhe standartet e mbajtjes se llogarive;
- d) pergatit dhe nenshkruan bilancin dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve ja paraqet Asamblese se Pergjithshme per miratim;
- e) siguron qe deklaratat e llogarive vjetore si dhe raporti i ecurise se biznesit dhe çdo deklarim tjetër i detyrueshem sipas ligjit ose statutit, jane bere siç duhet;
- f) siguron qe auditimi i librave dhe i te dhenave kryhet te pakten nje here ne vit nga eksperte kontabel te çertifikuar dhe raporti i llogaritaveve publike te çertifikuar t'i vihet ne dispozicion Asamblese se Pergjithshme;
- g) krijon nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e Shoqerise;
- h) raporton perpara Asamblese se Pergjithshme lidhur me zbatimin e politikave tregtare;
- i) kryen çdo detyre tjetër te caktuar nga ligji ose statuti.

11.4 Administratori mund te ndërmarrë apo të kërkoj kryerjen e të gjitha akteve që konsideron të nevojshme për arritjen e objektit të Shoqërisë pervec atyre që ligji apo statuti i rezervon Ortakeve apo organeve të tjera të Shoqërisë.

NENI 12 SHPËRBLIMI I ADMINISTRATORIT

12.1 Shpërblimi i administratorit të shoqërisë do të percaktohet nga Ortaket

KREU V KONTROLLI KONTABËL I SHOQËRISË VITI FINANCIAR DHE BILANCI

NENI 13. KONTROLLI KONTABËL

13.1 Kontrolli i jashtem kontabël i Shoqërisë kryhet nga Ekspert Kontabel të Autorizuar, në përputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi. Ortaket do të emerojne një apo më shumë ekspertë kontabël në ato raste kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshem ose kërkohet në baze të ligjit.

NENI 14 VITI FINANCIAR

14.1 Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor të cdo viti

NENI 15 BILANCI DHE REZERVAT

15.1 Me mbylljen e secilit vit financiar Administratoret marrin masat e nevojshme për hartimin e bilancit të aktivitetit për vitin financiar të mbyllur në mënyrë që ortakët të vendosin mbi miratimin apo ndryshimet e mundshme të tij brenda afateve të përcaktuara nga ligji.

15.2 Ortakët vendosin mbi ndarjen e dividendëve që rezultojnë si fitime sipas bilancit të miratuar rregullisht, pasi nga këto shuma janë zbritur humbjet e mundshme të viteve të mëparshme.

15.3 Ortakët në cdo moment mund të vendosin krijimin e rezervave, si edhe masën e tyre

KREU VI PRISHJA DHE NJOFTIMET

NENI 16 PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

16.1 Në rastin e likuidimit të Shoqërisë do të zbatohen dispozitat e parashikuara në ligjin nr. 9901 datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"

NENI 17 NJOFTIMET

17.1 Të gjitha njoftimet kërkesat ose komunikimet e tjera që u jepen personave ose që bëjnë personat sipas Statutit do të kryhen me shkrim ose përmes komunikimit elektronik (nëse ka) dhe do të konsiderohen të kryera në mënyrë të rregullt kur u dërgohen në adresat e deklaruara prej tyre pranë Administratoreve të Shoqërisë.

17.2 Njoftimet zyrtare të komunikimeve me anë të mjeteve elektronike vërtetohen sipas Legjislacionit për nënshkrimin elektronik dhe dërgohen në adresat elektronike të deklaruara prej tyre.

17.3 Në rastin kur një kuote zotërohet nga më shumë se një person të gjitha njoftimet do të drejtohen përfaqësuesit të bashkëzotëruesve të kuotës.

KREU VII
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

NENI 18
LIGJI I ZBATUESHËM

18.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë Akt themelimi dhe Statut dhe me ligjin shqiptar. Për sa nuk është parashikuar në këtë Akt, do të zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar në fushën e shoqërive tregtare.

18.2 Ky Akt hartohet në 4 (kater) kopje origjinale në gjuhën Shqipe, dhe pasi lexohet nga Ortaku i vetëm themelues, firmoset si më poshtë prej tyre.

Themeluesi i Kompanisë
Arlind Kote


Arlind Kote